



# BARAZI DHE



# BASHKËPUNIM

## UDHËHEQJA JONË

AVDI (13), LEONITA (13), ARBNORA (14), LABINOT (13), ENES (13), ISA (13), ALTIN (13)



### Ashtu siç e lexuat nga titulli, në këtë artikull do të shkruajmë për mënyrën se si e udhëheqim në vendin tonë

Njëherë kur ishim në klasë të VII-të bashkë me të gjithë nxënësit e klasës është dashur të rregullojmë dhomën e klasës sonë. Secili nga ne ka pasur për detyrë të rregulloj gjëra të caktuara në klasë. Mua dhe Isës na është dashur të ngjyrosim njëri nga bankat e klasës sonë. Mirëpo, ne nuk e dinim se me cilën ngjyrë ta ngjyrosim këtë bankë. Isa propozoi që ta ngjyrosim me ngjyrë të kuqe, kurse unë me ngjyrë të kaltër. Aty patëm shumë diskutime, sepse mendimet tona ishin të ndryshme. Kështu që vendosëm që gjysmën e bankës ta ngjyrosim me ngjyrë të kuqe e gjysmën tjetër ta ngjyrosim me ngjyrë të kaltër.

Kjo do të thotë se edhe pse ne kishim një mosmarrëveshje në fillim, në fund arritëm kompromis mes vete dhe kombinuam idetë tona. Dhe kjo është njëra nga mënyrat se si ne jetojmë në vendin tonë de-

mokratik.

Demokracia është formë e qeverisjes nga populli. Fjala demokraci rrjedh nga dy fjalët greke që në gjuhën shqipe i kuptojmë si „demos„ popull dhe „kratia„ qeverisje. Demokracia për së pari herë është paraqitur në Athinë, në vitin 507 p.e.s. Por, atëherë demokracia nuk ka qenë e plotë sepse vetëm burrat, të pasurit dhe personat mbi moshën 18 vjeçare kishin të drejtë të merrnin vendimet, pa përfshirë personat e moshuar të vendit. Këto vendime merreshin duke u mbledhur së bashku dhe diskutuar për nevojat e vendit të tyre. Kjo demokraci ishte demokraci e drejtpërdrejtë. A ka edhe Kosova demokraci të drejtpërdrejtë? Përgjigja e kësaj pyetje është jo, sepse Kosova udhëhiqet përmes parimeve të demokracisë përfaqësuese parlamentare. Dallimi është se në këtë lloj të demokracisë, përfaqësuesit janë personat e zgjedhur nga populli përmes votave tona për ta udhëhequr ata vendin tonë. Kjo na bën neve udhëheqësit e të gjithë Kosovës!




Ekipi i demokracisë



Të jemi të barabartë në udhëheqje

# PUSHTETI LIGJVËNËS

**SHPEND (13), DIARD (13), DRITA (13), AVDYL (13), LAZIM (13), ABDULVEHAB (13), FUAD (13)**



**Kuvendi përfaqëson popullin, miraton ligjet si dhe kontrollon Qeverinë për zbatimin e këtyre ligjeve**

## Se cila është rëndësia dhe roli i Kuvendit në një shtet demokratik, do të njoftoheni në artikullin tonë

Kuvendi i Republikës së Kosovës, këtë të premte feston Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë. Përse vallë Kuvendi duhet të shënoj këtë ditë, kur në Kosovë ka edhe institucione të tjera, mund të pyet dikush nga lexuesit ?

Në demokraci i gjithë pushteti rrjedh nga populli. Janë qytetarët ata të cilët përmes votës së tyre, iu japin pushtet deputetëve të marrin vendime për të ardhmen e vendit. Kjo është edhe forma më demokratike e udhëheqjes së një vendi. Sigurisht që nëse demokracia do të kishte një objekt, ai do të ishte Kuvendi. Për këtë arsye, në çdo vend ku ka demokraci është Kuvendi ai i cili e bën organizimin e kësaj dite madhështore, Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë. Ajo çka ndodh në këtë ditë janë organizime të ndryshme, si nga ana e Kuvendit, ashtu edhe nga organizatat jo qeveritare. Kështu, çdo qytetar i Republikës së Kosovës ka mundësinë dhe nderin që ta vizitojë institucionin më demokratik dhe ligjvënës. Pra, në një mënyrë apo në tjetrën, Kuvendi është shtëpia jonë e dytë.

Pa dyshim që është shtëpia më e madhe në vend, sepse është streha e afro 2 milionë banorëve. Është vendi ku diskutohen dhe merren vendime në të mirë të të gjithë qytetarëve, pa dallim moshe, gjinie, feje, etnie, etj. Kuvendi është vendi i diversitetit, sepse aty

punojnë 120 deputetë dhe asnjëri nuk është i njëjtë me tjetrin. Por, po ashtu edhe partitë janë të ndryshme prej njëra-tjetrës. Megjithatë, të gjithë janë të barabartë. Ne jemi shumë të lumtur që sot mësuam për këtë temë dhe ndihemi me fat që pas pak minutash edhe do të shohim nga afër shtëpinë tonë të dytë. Gjithash-tu, jemi shumë të gëzuar edhe për qytetarët e tjerë që ditën e premte do të kenë mundësi të vijnë për vizitë në këtë institucion.

Nga ato informata që sot i morëm e kuptuam që asgjë nuk është e rastësishme, madje as mbajtja e kësaj punëtorie. Kjo punëtori që ne sot erdhëm është një ndër kujtimet më të bukura që deri në këtë ditë i kemi përjetuar. E për këtë ndjenjë të mrekullueshme që e patëm, nga zemra e falemnderojmë Kuvendin, i cili e mbështet këtë projekt që na dha informata të shumta, si dhe i cili na ofroi mundësinë të shohim nga afër shtëpinë tonë të dytë.



**Grupi duke punuar në artikull**

# VOTA ËSHTË E ARDHMJA

VALMIR (13), ERBLINA (13), ERA (13), FJONA (13), LORIK (13)



## Në këtë artikull vota flet për veten dhe rëndësinë që ka ajo në jetën tonë

Unë jam vota! Gjithmonë e ardhmja juaj është në duart e mia. Jam aty për ju, sa herë që keni nevojë të jeni të drejtë me njëri-tjetrin.

Më kujtohet njëherë, isha e pranishme në mesin e disa vogëlushëve shumë të këndshëm. Ata kishin rënë në hall, sepse nuk e dinin cilën lojë ta zgjedhnin për të luajtur. Prandaj, vendosën që të më përdornin mua. Unë ju ndihmova dhe përmes meje ata arritën të ishin të gjithë të lumtur.

Votuan për lojën e tyre të preferuar dhe të gjithë u ndanë të kënaqur. Edhe unë po ashtu u ndjeva shumë mirë, pasi që isha unë arsyeja e lumturisë së tyre. Unë si votë, gjithmonë ndjem mirë kur njerëzit më përdorin. E di që duke më përdorur mua atë bëhen të drejtë me njëri-tjetrin dhe nuk ndodhin padrejtësi.

Prania ime është edhe në çështje më të rëndësishme, pasi është shumë efektive për çdo vendim-marrje në jetën e njerëzve. Vlen të theksohet edhe zgjedhja e përfaqësuesve të shtetit. Pa mua kjo zgjedhje nuk do të ishte e mundur. Edhe nëse do të ishte, nuk do të ishte e drejtë sepse populli nuk do të pyetej për përfaqësuesit e vet. Për këtë arsye, jam shumë e rëndësishme në demokraci. Asnjë shtet demokratik nuk mund të funksionojë pa mua. Unë iu jap fuqi qytetarëve, sepse duke më përdorur mua ata ia kalojnë fuqinë e tyre përfaqësuesve të vet.

Ndërsa këta përfaqësues kanë shumë detyra dhe përgjegjësi në përfaqësimin e personave që ua kanë besuar votën, do të thotë mua.



Ne zgjedhim të kujdesemi për vendin ku jetojmë



Gazetarët e artikullit



Anëtari i grupit tonë Asllani duke punuar në artikull

**Këtu vota vazhdon të flasë për rëndësinë që ajo ka në jetën tonë. Ju ftojmë të lexoni dhe të kuptoni rëndësinë e saj. Vërtet që ka vlerë të madhe**

Sa i përket mënyrës së votimit në procesin zgjedhor (sepse ju të dashur miq e kuptoni që mua më përdorin jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në procesin zgjedhor), çdo qytetar mbi moshën 18 vjeçare ka të drejtë të marrë pjesë në këtë proces.

Këta qytetarë mblidhen në vendin e caktuar ku ndodhen të gjitha mjetet me të cilat mund të kryhet ky proces. Zakonisht është dita, data dhe ora e caktuar dhe brenda kësaj kohe çdo qytetar duhet të jetë i pranishëm.

Për ta zhvilluar procesin tim, duhet të jenë personat përkatës që dijnë të vijojnë procedurat dhe t'u ndihmojnë personave për të mbajtur votën sa më të fshehtë.

Meqë secili qytetar më përdor për të votuar subjektin apo personin e preferuar që kandidon për përfaqësues unë duhet të mbahem e fshehtë.

E shihni pra, qytetarë të nderuar, prania ime në çdo zgjedhje tuajën, ju ndihmon që vendimi juaj të jetë sa më i sigurt dhe sa më i përshtatshëm për zgjidhjen e problemit tuaj. Ju faleminderit dhe ju lutem mos më shmangni në asnjë situatë të jetës suaj, kur nuk dini se si të vini në ndonjë përfundim.

Unë ju ndihmoj për çdo hall që keni dhe do ta zgjidhim së bashku duke u ndarë të kënaqur ju. Jam mënyra më demokratike për të arritur në një zgjedhje të kënaqshme për të gjithë. Jam këtu gjithmonë për ju.



Vajzat e grupit tonë

## NJË DITË AKTIVE

SARANDA (13), FAIK (13), RONA (13), DIANA (13), MIGENA (13), AZIZE (13)



### Më poshtë mund të gjeni një histori të këndshme se si ju dhe ne mund të jemi aktiv në vendin tonë

U zgjova herët në mëngjes. Isha zgjuar shumë e lumtur. Mirëpo, unë fare nuk e kuptoja arsyen pse. Mu kujtua diçka. Pse të mos bëj diçka të mirë për njerëzit? Diçka që mua s'do të më kushtonte asgjë, por që do të kishte rëndësi për shumë njerëz. Mendova të organizoja ndonjë projekt apo ligjëratë me një temë të caktuar që do të vetëdijësonte të rinjtë. Telefonova disa nga shokët dhe shoqet e mia. U tregova atyre një nga një se përse i telefonova. Ata u pajtuan me idenë time, e cila u pëlqeu shumë.

Kështu u mbledhëm të gjithë, por ende nuk e dinim temën. Disa propozuan temën për mbrojtjen e ambientit e disa për të drejtat e njeriut. Kurse unë... unë mendoja të bënim një projekt për ndalimin e përdorimit të substancave narkotike. Shokëve dhe shoqeve iu duk shumë e mirë kjo ide. Duke pasur parasysh që edhe ne jemi në moshë të re, morëm shumë informacione rreth kësaj dukurie të hidhur.

Të gjithë së bashku shkëmbyem tek një kompani e cila merrej me krijimin e afisheve të ndryshme. Menduam aktivitetin ta mbanim brenda shkollës, në ndonjërin prej klasave, që kishte më shumë hapësirë.

I treguam kryesuesit të kompanisë se çka dëshironim për fushatën tonë. Gjithashtu, i thamë se donim edhe ndonjë fotografi domethënëse. Ai na kuptoi mjaft mirë dhe na tha se do t'i kishim të gjitha falas, sepse donte

të na ndihmonte. Gjithashtu na tha se do të ishte i pranishëm në këtë organizim. Ne natyrisht, ishim më të lumtur se kurrë. I morëm afisheet dhe i vendosëm kudo: nëpër shtylla elektrike, nëpër dyqane (sigurisht me lejen e shitësve), në shkolla, etj.

Më në fund, dita shumë e rëndësishme për të gjithë ne erdhi. Ishim mjaft të lumtur, por në të njëjtën kohë edhe pak të shqetësuar. Kjo pasi nuk e dinim se sa do të kishte efekt dhe se a do të dilnim mirë në fushatën tonë të vogël. Përpara se të fillonte zyrtarisht fushata, ne morëm shumë lëvdata dhe përgëzime nga prindërit, nga mësimdhënësit, shokët dhe shoqet, etj. Për të kuptuar se çfarë ka ndodhur më tej, vazhdoni të lexoni në faqen tjetër.



Kurrë mos ndalo së qenuri aktiv në vendin tënd

**Kjo është pjesa e dytë e artikullit tonë. Këtu mund të mësoni se si shkoi dhe çfarë ndodhi në fushatën tonë për vetëdijësimin e të rinjve rreth substancave të ndryshme narkotike**

U mbledhën shumë njerëz. Kjo na lumturoi shumë të gjithëve. Meqë i kishim pjesët e ndara, të gjithë pjesarët e ekipit folëm. Njerëzit na dëgjonin me vëmendje të madhe. Kishte të moshuar, moshatarë, gra e burra. Të gjithë ishin mbledhur aty për të na dëgjuar neve. Gjithçka përfundoi me shumë sukses. Të gjithë na duartrokitën në fund.



Ne me të vërtetë u ndjemë shumë mirë. Neve na uruan për punën e bërë, por kishte edhe një shpërblim për neve. Kryesuesi i kompanisë që na krijoi afisheet kishte telefonuar gazetarët e një gazete të njohur. Ata kishin qenë aty gjatë gjithë kohës, por ne nga frika se a do të

dilnim mirë nuk i kishim parë fare. Ata do të shkruanin një artikull për ne.

E ne natyrshëm, e falenderuam edhe kryesuesin, por edhe gazetarët. Siç e lexuat dhe ju, aktiviteti kaloi për mrekulli. Fushata jonë pati një efekt shumë të madh tek të gjithë qytetarët.

Miq të dashur, nga kjo që po lexoni, ishte një ditë e zakonshme mirëpo ne e bëmë të jashtëzakonshme me punën dhe përkushtimin tonë.

Prandaj, të gjithë jemi të veçantë në mënyrën tonë dhe mund të bëjmë shumë për njëri-tjetrin dhe vendin tonë. Kurrë mos e harroni këtë!



**Të gjithë mund të jemi aktiv duke u kujdesur për ambientin, por edhe duke mësuar në shkollë**



**Grupi që ka shkruar këtë artikull**



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Sadri Misini“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-1 & VIII-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Shipashnicë, Kamenicë

**Kjo kopje nuk është e redaktuar nga Kuvendi i Kosovës**